



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

BULETINI Korrik – Shtator 2024



Përmes këtij buletini pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për periudhën kohore Korrik-Shtator 2024

Aktakuzë për vrasjen e rëndë në fshatin Balincë, Komuna Malishevë

Gjakovë, 1 korrik 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër nëntë të pandehurve në lidhje me rastin e vrasjes së rëndë të ndodhur më datë 31 gusht 2023, në fshatin Balincë, Komuna Malishevë, pasi që ekziston dyshimi i bazuar mirë se të njëjtit kanë kryer veprat penale si në vijim:

Për të pandehurin Xh.G., ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Vrasja e rëndë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 të KPRK-së dhe veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurit Xh.G., F.G., K.G., A.G., dhe N.G., ekziston dyshimi i bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Për të pandehurin K.G., ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurin A.G., ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurin N.G., ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Pjesëmarrja në rrahje” nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurit L.K., D.K., Q.K., dhe A.M., ekziston dyshimi i bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Aktakuzë kundër dy personave për veprat penale vjedhja e rëndë dhe blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale

Gjakovë, 2 korrik 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit Sh.Xh., për veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 paragraf.2, nën par.2.1 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin V.D., për veprën penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale” nga neni 333 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i parë Sh.Xh., me dt.07.06.2024, në Gjakovë, saktësisht në objektin në afërsi të ngrohtores së qytetit, me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, ia merre pasurinë e luajtshme të dëmtuarit N.K., në atë mënyrë natën kritike shkon në vendin e lartcekur dhe merr 40 (dyzetë) profile te dritareve të reja të pa montuara të cilat i dëmtuari i kishte blerë atë ditë në vlerë prej 20,000.00 € (njëzet mijë euro), e më pasë largohet nga vendi i ngjarjes dhe të njëjtat i shet tek i pandehuri V.D., me ç’ rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në vlerë 20,000.00 € (njëzet mijë euro).

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 paragraf.2 nën par.2.1 të KPRK-së.

Po ashtu në pikën e dytë të dispozitivit të aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i dytë V.D., me datë 07.06.2024, në Gjakovë, konkretisht në hekurishten e tij, blen nga i pandehuri profilet e dritareve të aluminit, për te cilat ka mundur ta dije se janë të vjedhura, në shumen e të hollave prej 120 euro, shumë kjo dukshëm jo proporcionale në treg e për të cilin fakt dhe këto rrethana e nga çmimi i ulet i blerjes, i pandehuri, ka mundur të dije se janë përfituar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, me ç’ rast përfiton materialisht për vete dhe duke e fshehur sendin njëkohësisht i shkakton dëm material të dëmtuarit N.K.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale” nga neni 333 par.3 lidhur me par 2 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Kryeprokurori z. Enis Gashi dhe Prokurorët e Prokurorisë Themelore Gjakovë, takohen me përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Policisë dhe Stacioni Policor Gjakovë

Gjakovë, 23 korrik 2024 - Prokuroria Themelore në Gjakovë – Kryeprokurori z. Enis Gashi, së bashku me Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, pritën në takim Shefin e Sektorit të Hetimeve Rajonale të Policisë dhe atë të Stacioni Policor Gjakovë. Tema kryesore e këtij takimi të rëndësishëm ishte koordinimi për kryerjen e detyrave dhe sfidat e ndryshme që paraqiten në punën e përbashkët.

Gjatë takimit, u theksua rëndësia e një bashkëpunimi të ngushtë dhe të efektshëm për të adresuar sfidat aktuale që ndikojnë në stabilitetin dhe rendin publik në rajonin tonë. Diskutimet u përqendruan në identifikimin dhe trajtimin e këtyre sfidave, duke përfshirë edhe çështje specifike që kanë ndikim të madh në sigurinë e qytetarëve.

Kryeprokurori z. Gashi, theksoi rëndësinë e një bashkëpunimi të fortë ndërmjet prokurorisë dhe policisë, duke vlerësuar kontributin e zyrtarëve policorë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Ai gjithashtu shprehu angazhimin e tij dhe të prokurorëve për të mbështetur dhe forcuar këtë bashkëpunim në mënyrë që të përmbushen objektivat e përbashkëta.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Policisë dhe Stacioni Policor Gjakovë, shprehën gatishmërinë dhe përkushtimin e tyre për të vazhduar me përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër krimit dhe ruajtjen e sigurisë publike, duke shprehur mirënjohjen e tyre për mbështetjen e vazhdueshme të Kryeprokurorit z. Gashi dhe të prokurorëve, theksuan rëndësinë e një koordinimi të vazhdueshëm për të arritur rezultate të suksesshme.

Ky takim është një shembull i qartë i përkushtimit të institucioneve tona për të punuar së bashku dhe për të adresuar sfidat që paraqiten në mënyrë të përbashkët, me qëllim të garantimit të një mjedisi më të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e rajonit tonë.



Kërkohet paraburgimi ndaj dy personave për veprat penale sulm ndaj personit zyrtar dhe pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare

Gjakovë, 12 gusht 2024, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurve me inicialet Gj.P., dhe P.I., ka paraqitur kërkesë, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se me datë 10.08.2024 rreth orës 23:20 min, në Gjakovë, të pandehurit në bashkëkryerje dhe me dashje sulmojnë personin zyrtar në lidhje me detyrën zyrtare, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupor – të dëmtuarit zyrtarit policor M.S., në atë mënyrë që, natën kritike përderisa i dëmtuari kishte vërejtur se një person kishte dëmtuar një pasqyrë të motoçikletës që ishte e parkuar tek një lokal, i njëjti ju benë me dije që të ndalën, e me pas i'u prezantohet se është polic, me ç 'rast të njëjti fillimisht i drejtohen me fjalë ofenduese dhe me pas që të dy të pandehurit e kapin për fyti të dëmtuarin e shtynë duke e përplasur për toke, duke tentuar që t'ia marrin armën zyrtare nga brezi, ku si pasojë e këtyre veprimet të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të rënda trupore. Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale, sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par. 6 lidhur me par. 2, dhe par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Me datë, kohë dhe vend të njëjti të pandehurit duke vepruar në bashkëkryerje me përdorimin e forcës tentojnë të pengojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtar dhe atë zyrtarët policor/të dëmtuarit E.G., A.H. dhe E.P., në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit ishin në detyrë zyrtare, përkatësisht pas pranimi të informatës nga baza lidhur me rastin e lartcekur, pasi të njëjtit i përgjigjen rastit dhe të pandehurve u bëhet me dije se janë të arrestuar të njëjtit refuzojnë dhe vazhdojnë duke rezistuar pengojnë arrestimin e tyre. Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

Ndërmjetësimi ?

·Ndërmjetësimi është një procedurë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku palët vendosin për përmirësimin e raporteve të tyre.

·Me kosto shumë më të ulët, konfidenciale dhe për një kohë shumë më të shkurtër.

Prokururia Themelore Gjakovë, gjatë periudhës janar-korrik 2024, ka zgjidhur 245 lëndë përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Prokuroria Themelore në Gjakovë Zgjidh 245 Lëndë përmes Ndërmjetësimit

Gjakovë, 16 gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, gjatë periudhës janar – korrik 2024, ka zgjidhur me sukses 245 lëndë përmes procedurës alternative të ndërmjetësimit.

Ndërmjetësimi është një procedurë për zgjidhje paqësore të konflikteve, duke shmangur procedurat e gjata dhe duke promovuar një kulturë të marrëveshjeve reciproke.

Përmes kësaj procedure, Prokuroria Themelore e Gjakovës, ka kontribuar në uljen e numrit të çështjeve që ngarkojnë gjykatat dhe në të njëjtën kohë, ka garantuar drejtësi efikase dhe më të qasshme për qytetarët.

Kjo arritje është një pasqyrim i përkushtimit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës, për të adresuar në mënyrë të efektshme nevojat e shoqërisë për zgjidhje të drejta dhe të qëndrueshme përmes përdorimit të procedurave alternative.

Kërkohet paraburgimi ndaj të pandehurit për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm

Gjakovë, 22 gusht 2024 - Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet T.K., ka paraqitur kërkesë, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se me datë datë 21.08.2024 rreth orës 17:45 minuta para objektit të policisë së Kosovës-Drejtorisë Rajonale në Gjakovë, me dashje dhe me qëllim që të bëjë shkatërrim të objektit dhe të automjeteve zyrtare ka shkaktuar dëm material dhe rrezik të madh për jetën e zyrtarëve policor, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri T.K., i pajisur me katër shishe të mbushura me benzinë dhe vaj të djegur, afrohet tek objekti i policisë dhe i hedh të gjitha shishet në drejtim të objektit të cilat përfundojnë në dy automjete zyrtare të policisë ku të njëjtat i kaplon zjarri mirëpo me shpejtësi reagojnë zyrtarët policorë dhe e shuajnë zjarrin dhe më pas e arrestojnë të pandehurin i cili ishte duke u larguar nga objekti i policisë.

Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Kërkohet paraburgimi ndaj të pandehurit për veprën penale marrja e ryshfetit

Gjakovë, 23 gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet Q.I., ka paraqitur kërkesë, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se me dt.21.08.2024, në mënyrë të kundërligjshme në cilësinë e zyrtarit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, Zyra Ponoshec, me qëllim që t'i sjellë vetit përfitim pasuror të kundërligjshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka kërkuar qytetarit – të dëmtuarit, shumën e parave prej 170€ për gjenerimin e numrit personal në sistemin elektronik të ARC-së, për bashkëshorten e tij.

Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 par.1 të KPRK-së.



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

1 - 31 GUSHT 2024

134 Aktakuza, kundër **151** personave

14 Kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj **21** personave

Prej tyre **19** aktakuzat dhe **9** kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit, për shkak të veprës penale “Dhuna në familje”



Prokuroria Themelore në Gjakovë, gjatë muajit gusht 2024, ka ngritur 134 aktakuza, si dhe 14 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit

Gjakovë, 6 shtator 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka përmbyllur një muaj të suksesshëm në luftën kundër krimit, duke ngritur gjithsej 134 aktakuza, kundër 151 personave për vepra të ndryshme penale, si dhe 14 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj 21 personave, gjatë periudhës 1 – 31 gusht 2024, duke demonstruar përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit për të ruajtur rendin dhe sigurinë në komunitet.

Gjatë kësaj periudhe nga numri total i këtyre aktakuzave, dhe kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit, janë ngritur 19 aktakuza ndaj 20 personave, janë paraqitur 9 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj 9 personave, për veprën penale “Dhuna në familje”.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, mbetet e angazhuar për të siguruar drejtësi dhe për të ndjekur penalisht të gjithë ata që shkelin ligjin, duke vazhduar me përkushtim në misionin e saj për të mbrojtur qytetarët dhe të drejtat e tyre.

Prokuroria Themelore në Gjakovë ka ngritur aktakuzë kundër shtatë personave për trembëdhjetë vepra penale

Gjakovë, 17 shtator 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, kundër shtatë (7) personave, pasi që ekziston dyshimi i bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale si në vijim:

Për të pandehurin A.J., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Për të pandehurin B.J., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 1 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurin Z.Z., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 1 të KPRK-së.

Për të pandehurin M.P., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurin G.Ll., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Fajdeja” nga neni 331 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për të pandehurin Xh.L., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331 par 1 të KPPK-së.

Për të pandehurin H.Gj., ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale “Ndihma në kryerjen e veprës penale fajdeja” nga neni 331 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenet 33 dhe 77 të KPRK-së.

Ndërsa, konform nenit 241 par. 1 nën par 1.9 lidhur me nenet 115 par. 2, 274 të KPPRK-së, gjykatës i propozohet konfiskimi i përhershëm:

Dymbëdhjetë (12) vetura, tri (3) moto çikleta, 4 (katër) armë të llojeve të ndryshme, para, etj si në aktakuzë.

Prokurori i Shtetit, me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge

Gjakovë, 24 shtator 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet B.P., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet B.P., me parë e gjer me dt.23.09.2024, rreth orës 21:10 në rr. Gasper Karaqi në Gjakovë, pa autorizim dhe me qëllim shitje ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotik në atë mënyrë që Njësia e Trafikut përderisa ndodheshin në pikë kontroll, kanë sinjalizuar për t'u ndalur të pandehurin i cili po e drejtonte veturën VW Golf, ku i njëjti i është shmangur Njësitit të Trafikut, duke tentuar të ikë përmes rrugës në drejtim të Gjakovës, policia kanë vazhduar në drejtim të tij dhe kanë arritur t'a ndalojnë, pasi që i njëjti është njoftuar për arsyen e ndaljes, është vërejtur një shqetësim tek i njëjti, për një moment ka marrë dy qese të zeza dhe ka filluar të vrapojë në një distancë prej 300 metra i pandehuri ka hedhur qesen e madhe në sasi rreth 995 gr, narkotik, ndërsa qesen tjetër më të vogël në sasi prej 571 gr, ka vazhduar që ta mbajë në dorë, pasi është arrestuar është hapur qesja dhe është vërejtur se ka lëndë të dyshuar për narkotik, në peshë të përgjithshme rreth 1 kg e 566 gram narkotik, të gjitha të sekuestruar dhe me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.